REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 975/20
Datë/Datum. 19.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: **Ministria e Arsimit dhe Shkencës**

Për: **208 Udheheqesi-20-3745-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i Çerdhes në Mitrovicë**

# ANKESË

**1. Identifikimi i ankuesit***

Astraplan SHPK
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

Rr. Mehmet Gradica Hyr. 5/6, Bregu i Diellit
*(Adresa)*

Prishtinë
*(Vendi)*

10000
*(Kodi postar)*

038 555 045
*(Numri Telefonit)*

038 555 045
*(Numri i Faks-it)*

Florim Istrefi
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

astra_plan@hotmail.com
*(Adresa elektronike)*

19.11.2020
*(Data e parashtrimit të ankesës)*

ASTRAPLAN

*(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me* *PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

______________________________

*(Emri i avokatit)*

______________________________

*(Adresa e plotë)*

______________________________ ______________________________

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

______________________________

*(Adresa elektronike)*

______________________________ ______________________________

*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*Publikimi i tenderit ka qene ne E-PROKURIM, publikimi i tenderit është bere me datën* 20.07.2020 *ndërsa hapja e ofertave është me datën* 07.08.2020 *si kriter i tenderit tenderuesi i përgjegjshëm çmimi me i ulet.*

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

**Po** [ ] **Jo** [X]

JO, hapja është bere përmes e-prokurimit

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [X] **Jo** [ ]

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [X] **Jo** [ ]

Me datën 29.09.2020 kemi bere kërkesë për RI-SHQYRTIM pran AK-s, duke kërkuar qe te ri-shqyrtojnë vendimin e marre ne lidhje me këtë aktivitet, ku me datën 05.10.2020 AK na kthen përgjigje duke e aprovuar kërkesën tone për ri-shqyrtim dhe aktivitetin e prokurimit e kthen ne ri-vlerësim.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*
*Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Ministarstvo za Obrazovanje i Nauke -Ministry of Education and Science*

| | |
|---|---|
| DATË/A | 05.10.2020 |
| REFERENCË: | MASHT/ZP |
| PËR/ZA/TO: | Operatorin Ekonomik: **Astraplan SH.P.K. K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6 10000 PRISHTINË** |
| CC: | Z. Agim Berdyna, u.d. Sekretar i Përgjithshëm |
| Përmes: | Arkivit |
| NGA/OD/FROM: | Xhemajl Buzuku, Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim mbi shqyrtimin e Kërkesës për Rishqyrtim të dt. 29.09.2020 |

Ministria e Arsimin, Shkencës dhe Teknologjisë, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik **Astraplan SH.P.K. K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6 10000 PRISHTINË**, të datës 29.09.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i Çerdhes në Mitrovicë**, me numër të prokurimit: **208020015511**, kundër vendimit të AK-së të datës 24.09.2020 të publikuar përmes platëformes E-prokurimi, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

**Aprovohet pjesërisht Ankesa Lenda kthehet ne Rivlersim lidhur me** kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Astraplan SH.P.K. K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6 10000 PRISHTINË**, të datës 29.09.2020, të dërguar në formë elektronike nga OE, **SI E BAZUAR**

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik: **Astraplan SH.P.K. K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6 10000 PRISHTINË**, si palë e pa kënaqur ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datë 29.09.2020, kundër vendimit të AK-së, lidhur me tenderin: **Ndërtimi i Çerdhes në Mitrovicë**, me numër të prokurimit: **208020015511**, duke pretenduar se janë bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, në:

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet lidhur me pikat ankimore te OE:

Aprovohet Pjesërisht Ankesa Lenda kthehet ne Rivlersim lidhur me kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Astraplan SH.P.K. K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6 10000 PRISHTINË.**

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHPS-së duhet të dorëzohet brenda (10) ditëve pas këtij vendimi

Vendimi dorëzohet:

1. 1x1 Operatorin Ekonomik: **Astraplan SH.P.K. K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6 10000 PRISHTINË** 1x1 Anëtarëve të Komisionit
2. 1x1 Arkivit të MASH-it

Ku me datën 12.11.2020 ne kundërshtim me LPP-n e rekomandojnë për kontrate OE me çmimi me te larte se sa ne dhe atë për **58,600.00 €.**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
*Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Ministarstvo za Obrazovanje i Nauke -Ministry of Education and Science*

**B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]**
*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik*

**Titulli i kontratës: Ndërtimi i Çerdhes në Mitrovicë**

| Nr. i Prokurimit: | 208 | 2 | 0 | 0 | 1 | 5 | 5 | 1 | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

| Nr. | Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës | Vlera totale e ofertave[2] |
|---|---|---|
| 1 | Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.SH. WORLD MEDIUM ; NDËRTIMI ING SH.P.K.; Isuf A. Krasniqi B.I., Rruga Bashkim Gashi, -24000, GUNCAT | 572.063,92 € |
| 2 | "Euro Project " SH.P.K., Abaz Thaqi Nr.6, 41000, SKENDERAJ | 556.328,96 € |
| 3 | Mercom Company SH.P.K., 20/3 FAZLI GRAJÇEVCI, 10000, PRISHTINË | 588.105,12 € |
| 4 | Termomontimi shpk, Zona Industriale, 10000, Prishtine | 656.923,47 € |
| 5 | **Astraplan SH.P.K., K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6, 10000, PRISHTINË** | **488.000,00 €** |
| 6 | Grup i Operatorëve Ekonomik A con SH.P.K.; GSC SH.P.K., Kodra e Diellit ,Z e jugut L 5/5, -, PRISHTINË | 588.691,17 € |
| 7 | Grup i Operatorëve Ekonomik nnp standard shpk; Arifaj.shpk, Dardani su1/3a, 10000, Prishtinë | 557.308,53 € |
| 8 | **Olti Trasing SH.P.K., Bill Klinton, 10000, PRISHTINE** | **546.600,00 €** |
| 9 | Grup i Operatorëve Ekonomik AC ing SH.P.K.; " VELLEZRIT HOTI " SH.P.K., Qendra Tregtare Bregu i Diellit, Lok.Nr.47, -, PRISHTINË | 532.215,15 € |
| 10 | N.N.SH. " TOP PROJEKT ", AGIM RAMADANI NR. 82/8- L. E UNIVERSITETIT, -, PRISHTINË | 537.928,66 € |
| 11 | Grup i Operatorëve Ekonomik LIMITPROJECT SH.P.K.; Company Murseli SH.P.K.; DAR ING SH.P.K.; N.N. GLOBAL - ING, Prishtine,Hyzri Talla, Qendra Tregtare, p.n, 10000, Prishtine | 588.500,53 € |
| 12 | NPN EUROING SH.P.K., Xhelal Hajda -Toni, 21000, RAHOVEC | 597.599,66 € |
| 13 | H & B - Consulting SH.P.K., Bregu i Diellit ,Rr.Mehmet Gradica Obj.7 Nr.2 , Prishtinë, -10000, PRISHTINË | 597.537,83 € |

**Rezultati i aktivitetit te prokurimit:** ***Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë:*** **Operatori Ekonomik Olti Trasing SH.P.K., Bill Klinton, 10000, PRISHTINE, në vlerë totale të ofertës: 546.600,00 €**

Data: 12.11.2020

Emri dhe mbiemri i ZPP: Xhemajl Buzuku

Ku ne si OE i diskriminuar përsëri kemi kërkuar me 16.11.2020, rishqyrtim te vendimit për këtë aktivitet te prokurimit komfor nenit 108/A i LPP-së si dhe brenda afateve ligjore, ku me 17.11.2020 na është refuzuar kërkesa si e pa bazuar.

Nr. Prot: 3183
Datë: 17/11/2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*
*Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Ministarstvo za Obrazovanje i Nauke -Ministry of Education and Science*

| | |
|---|---|
| DATË/A | 17.11.2020 |
| REFERENCË: | MASHT/ZP |
| PËR/ZA/TO: | Operatorin Ekonomik: Astraplan SH.P.K., K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6, 10000, PRISHTINË |
| CC: | Z. Agim Berdyna, u.d. Sekretar i Përgjithshëm |
| Përmes: | Arkivit |
| NGA/OD/FROM: | Xhemajl Buzuku, Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim mbi shqyrtimin e Kërkesës për Rishqyrtim të dt. 17.11.2020 |

Ministria e Arsimin, Shkencës dhe Teknologjisë, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik Operatorin Ekonomik: Astraplan SH.P.K., K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6, 10000, PRISHTINË, të datës 16.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i Çerdhes në Mitrovicë, me numër të prokurimit: 208020015511, kundër vendimit të AK-së të datës 16.11.2020 të publikuar përmes platëformes E-prokurimi, nxjerrë këtë:

**VENDIM**

**Mbi REFUZIMIN** e kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga Operatori Ekonomik: Operatorin Ekonomik: Astraplan SH.P.K., K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6, 10000, PRISHTINË, të datës 16.11.2020, të dërguar në formë elektronike nga OE, **SI TË PA BAZUAR**

**Arsyetim**

Operatori Ekonomik: Operatorin Ekonomik: Astraplan SH.P.K., K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6, 10000, PRISHTINË, si palë e pa kënaqur ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datë 16.11.2020, kundër vendimit të AK-së, lidhur me tenderin: Ndërtimi i Çerdhes në Mitrovicë, me numër të prokurimit: 208020015511, duke pretenduar se janë bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, në:

**Pretendimet Ankimore**

Operatori Ekonomik: Operatorin Ekonomik: Astraplan SH.P.K., K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6, 10000, PRISHTINË, pretendon se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të:

Nenin 108/A i LPP-së - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 10 i LPP-së - Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 56 i LPP-së-Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e
Kontratave
Neni 60 i LPP-së - Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale
Neni 49.19 te RRUOPP-s

**Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet lidhur me pikat ankimore te OE:**

Ne si AK kemi shqyrtuar në detaje pretendimet ankimore te parashtruesit të Kërkesës për Rishqyrtim, nga ana juaj dhe konsiderojmë se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara, andaj mbesim prapa vendimit mbi eliminim lidhur me këtë tender.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHPS-së duhet të dorëzohet brenda (10) ditëve pas këtij vendimi

**Vendimi dorëzohet:**

1. 1x1 Operatorin Ekonomik: Operatorin Ekonomik: Astraplan SH.P.K., K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6, 10000, PRISHTINË
2. 1x1 Anëtarëve të Komisionit
3. 1x1 Arkivit të MASH-it

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

**Nenin 108/A i LPP-së - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**
**Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
**Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**
**Neni 10 i LPP-së - Mjetet për promovimin e Transparencës**
**Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**
**Neni 56 i LPP-së-Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**
**Neni 60 i LPP-së - Kriteret për Dhënien e Kontratës**
**Neni 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale**
**Neni 49.19 te RRUOPP-s**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**Nenin 108/A i LPP-së - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

Është për tu çuditur fakti se si zyra e prokurimit me datën 05.10.202 e aprovon kërkesën tone për rishqyrtim, dhe pas rishqyrtimit na eliminon përsëri si dhe me te njëjtën arsye, shih me larte vendimin nr. 2479.

**Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelej te nenit 6 pasi nuk është kujdesur qe ne përputhje me neni 6 piken 1 dhe 2 te këtij neni ku të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, dhe na ka diskualifikuar edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kushtet e kërkuara ne njoftim për kontrate dhe ne dosje te tenderit. Arsyet e eliminimit nuk qëndrojnë dhe nuk janë te mbështetura ne LPP-e as ne RRUOPP, si dhe ka rekomanduar për kontrate një kompani qe është për 11 % me çmim me te larte se oferta e jone, saktësisht për **58,600.00 €.**

**Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelej te nenit 7 pasi nuk i ka trajtuar te gjithë OE-t te barabartë, na ka diskualifikuar edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kushtet e kërkuara ne njoftim për kontrate dhe ne dosje te tenderit. Arsyet e eliminimit nuk qëndrojnë dhe nuk janë te mbështetura ne LPP-e as ne RRUOPP.

Si ka mundësi te eliminohemi ne si OE duke mos u bazuar na asnjë nen apo ligj te LPP-s e as RRUOPP-s, dmth është eliminim nga gara për arsye dëshirash.

**Neni 10 i LPP-së - Mjetet për promovimin e Transparencës**

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelej te nenit 10 pasi qe gjat qasjes ne dokumente kemi kërkuar komplet raportin e komisionit vlerësues, ku për çudi duke u thirrur ne RRUOPP na e ka ofruar deri faqe 20 gjoja se ne RRUOPP po u lejojka vetëm deri faqe 20, me siguri z. Buzuku e ka një RRUOPP personale, sepse edhe arsyeja e eliminimit tone e edhe arsyeja e mos dhënies se raportit te komisionit vlerësues nuk janë ne RRUOPP-n ne ueb faqen e KRPP-s, ndërsa pjesën tjetër nuk na ka ofruar as me pa e as me na dhen enje kopje qe ne dyshojmë se z. Buzuku nuk ka raport te vlerësimit nga te gjithë anëtarët siç kërkohet ne LPP saktësisht neni 59 paragrafi 1, por e ka bere vlerësimin sipas dëshirës, këtë fakt e vërteton edhe kërkesa për qasje ne dokumente ne herën e pare ku edhe pas 3 kërkesave nuk na ofruan qasje ne dokumente.

**Neni 59**

**Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**

1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerës dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjë plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të proku elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacion dytësor lidhur me këtë çështje.



**ASTRAPLAN**
NDËRMARRJE NDËRTIMORE - PROJEKTUESE
Prishtinë

Nga: **"ASTRAPLAN" Shpk Prishtinë**
Për: **MINISTRIA E ARSIMIT**
Lënda : **Kërkesë për qasje në dokumente**
Projekti: **Ndërtimi i Çerdhes në Mitrovicë**
Nr. Prokurimit: **208 Udheheqesi-20-3745-5-1-1**
Nr i brendshëm: **208020015511**

Të nderuar, kërkojmë që të na mundësohet qasja në dokumente konform LIGJI Nr. 05/L -068 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN Nr. 04/L-237, LIGJI Nr. 05/L -068, Neni 6, Pika 2. (Neni 10 i ligjit bazik Nr. 04/L-042, paragrafët 3 ). në lidhje me aktivitetin e prokurimit:
**Ndërtimi i Çerdhes në Mitrovicë**
**Nr i prokurimit: 208 Udheheqesi-20-3745-5-1-1, Nr i brendshëm: 208020015511**
***Ne kemi pranuar një njoftim automatik nga e-prokurimi*** *(Versioni i tanishëm: 24.09.2020 15:16 -B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK-njoftimi-Mitrovicë-Çerdhja.docx)*

Kërkesë për qasje në dokumente

Përshëndetje,

Të nderuar, kërkojmë që të na mundësohet qasja në dokumente konform LIGJI Nr. 05/L -068 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN Nr. 04/L-237, LIGJI Nr. 05/L -068, Neni 6, Pika 2. (Neni 10 i ligjit bazik Nr. 04/L-042, paragrafët 3). në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i Çerdhes në Mitrovicë**
**Nr i prokurimit: 208 Udheheqesi-20-3745-5-1-1, Nr i brendshëm: 208020015511**
***Ne kemi pranuar një njoftim automatik nga e-prokurimi*** [illegible]
Ju lutemi që takimin për qasje në dokumente të na e leni nesër me datë. 25.09.2020
Ju lutemi konfirmoni pranimin e e_mailit.
Gjithë të mirat

Get Outlook for Android

Reply | Forward

Kërkesën për qasje e kemi derguar me dt 24.09.2020 ne ora 16:31 dhe ende nuk na keni kthyer pergjigje.
Ju lutemi që takimin për qasje në dokumente të na e leni neser me dt. 29.09.2020 paradite.

Prishtinë
28.09.2020

"Astraplan" Sh.p.k.

Info: Tel/Fax: +383 (0) 38 555 045, Mob:+383 (0) 44 20 29 23
e-mail: astra_plan@hotmail.com, astra_plan@yahoo.com

**Nenit 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**

Autoriteti Kontraktues ka bere vlerësim te ofertave ne kundërshtim me nenin 59 duke bere shkelje flagrante te këtij neni, për shkak se ne si OE i plotësojmë te gjitha kërkesat ne njoftim për kontrate dhe DT, eliminimi i kompanisë ton nga gara është ne kundërshtim te plotë me nenin 59, paragrafin 4, citojmë paragrafin 4 te nenit 59 te LPP-s

*("Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.").*

Eliminimi i jashtëligjshëm i kompanisë tone vërtetohet edhe ne vendimin e AK-s qe njofton OE pjesëmarrës ku ne letrën (pjesën ku na drejtohet) neve si kompani nuk ju ka plotësuar asnjë nga kushtet për eliminim dhe ne funde e krijon një kusht gjoja se për këtë arsye. PA KOMENT!!!!!!!!!

Shih foton e me poshtme.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet Formularin e paraqitjes së tenderit
☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
☐ Nuk i keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant te prokurimit;
☐ Gabimi (et) aritmetikor i evidentuar(a) është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës;
☐ Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative.

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]
☐ Nuk keni paraqitur një deklaratë të qartë se të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe, në rast se grupit i është dhënë kontrata, performancen e kontratës;
☐ Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga secili anëtar, e cila konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër pjesëmarrës në procedurën e njëjtë të prokurimit;
☐ Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga të gjithë anëtaret e grupit e cila autorizon partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit;
☐ Partneri juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

[Në rast të nënkontraktimit]

☐ Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

☐ Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara te cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;

☐ Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme te kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;

☐ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe te kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

ARSYETIM
[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

Një inxhinier i dip. i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik – 2 vite përvojë pune pas diplomimit. Ka kontrat të rregullt i njejti është edhe tek Operatori Ekonomik AC ing me kontrat të rregullt dhe ne listë të pagave ndersa tek Operatori Astraplan nuk është në listën e pagave.

**Jemi tejet te brengosur se si një zyrtar prokurimi i certifikuar merr guximin për te eliminuar OE konkurrues nga gara duke mos e bazuar ne ligj arsyen e eliminimit, dmth me fjale tjera jemi eliminuar bash për dëshirën e ndokujt.**

**Neni 56 i LPP-së-Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelej te nenit 56 pasi nuk i ka vlerësuar ofertat dhe përzgjedhjen e OE-ve për dhënien e kontratës sipas këtij neni. Neni 56 paragrafi 3 e sqaron qarte se nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Ku me këtë raste nuk është cekur se një inxhinier nuk mund te jet ne dy kompani konkurruese,

dhe është shume procedure e thjeshte sepse vetëm një fitues do te shpallet ne këtë aktivitet te prokurimit. (citojmë paragrafin 3 te nenit 56 te LPP-s)

3. **Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.**

**Neni 60 i LPP-së - Kriteret për Dhënien e Kontratës**

Autoriteti kontraktues ka bere vlerësim te ofertave ne kundërshtim me nenin 60 e jo ne përputhje me ketë nen duke bere shkelje te këtij neni saktësisht paragrafin 1 i cili thotë: citojmë paragrafin 1 te nenit 60 te LPP-s

*("1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:*
*1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;*
*1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është")*

Ne rastin konkret kushte për shpërblimin me kontrate ka qene: ***Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët,*** qe ka te bej me piken 1.1 te këtij neni dhe AK-ja ka bere shkelje duke rekomanduar për kontrate një OE qe ka ofruar çmimin shume me te larte se kompania jone **58,600.00 € apo shprehur ne %, për 14 % me çmim me te larte se sa oferta e Astraplan shpk,** shih tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës | Vlera totale e ofertave |
|---|---|---|
| 8 | Olti Trasing SH.P.K., Bill Klinton, 10000, PRISHTINE | 546.600.00€ |
| 5 | Astraplan SH.P.K., K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6, 10000, PRISHTINË | 488.000,00 € |
| | Ndryshimi ne çmim (€) nr.2-nr.5= | 58,600.00 € |
| | Ndryshimi ne çmim (%) nr.2-nr.5= | 11 % |

**Neni 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale**

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelej te Neni 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pasi qe ne i kemi plotësuar te gjitha kërkesat sipas këtij neni dhe Ak-ja na ka diskualifikuar edhe për kundër kësaj. Arsyet e eliminimit nuk qëndrojnë dhe nuk janë te mbështetura ne LPP-e as ne RRUOPP.

**Neni 49.19 te RRUOPP-s** Autoriteti Kontraktues ka bere shkelej te këtij neni pasi qe nuk e ka respektuar gjat procesit te vlerësimit te tenderëve, *citojmë* **nenin 49.19 Është bërë e qartë në nenin 56.3 të LPP-së, se një kandidat nuk do të diskualifikohet, përjashtohet, apo eliminohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kushti ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe / ose në dokumentin e para-kualifikimit.**

***Nga te gjitha te cekurat me larte, konstatojmë se komisioni vlerësues nuk ka vepruar komfor LPP-s dhe na ka eliminuar për kundër se i kemi plotësuar te gjitha kushtet e kërkuara ne njoftim për kontrate dhe ne dosje te tenderit. Arsyet e eliminimit nuk qëndrojnë dhe janë ne kundërshtim te plote me LPP-e dhe RRUOPP.***

**Pas përshkrimit të fakteve të lartshënuara dhe gjendjes faktike, nga paneli shqyrtues në OSHP kërkojmë që me rastin e shqyrtimit të ankesës sonë të bëjë sintezën dhe analizën e dyshimeve, kërkesave dhe pretendimeve të ngritura në këtë ankesë dhe se këtë aktivitet prokurimi ta kthej në *RI-VLERËSIM pasi qe e plotësojmë kushtin tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët.***

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Humbja e kohës, shpenzimet material ne përgatitjen e ofertës, fitim i humbure sepse po te behej vlersimi real dhe sipas kushteve ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrate, Ne do duhej te ishim shpallur fituesit e kësaj oferte nga komisioni vleresues, *pasi qe e plotësojmë kushtin Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulet.***

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- *a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- *e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- *f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
- *g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*